



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-13691

Data: 20.08.2026

P r i z r e n

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,
me kërkesën e **Lon Gjurgjaj nga Prizren,** me banim në rrugën “ Anton Qeta” me të cilën pala ka kërkuar leje për ekzekutimin e punimeve për: gropimin e rrugës dhe kuçje në rrjetin e kanalizimit e në bazë të nenit 3 paragrafit 1, pika 1.27 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor me Nr.04/L-174 të Dt.31.07.2013, nenit 3.1.1, 1.2, 1.4, 1.17, 1.24, e në lidhje me nenin 4, 1.2, si dhe nenit 5, 1.1 si dhe nenin 14.1.2, të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110, dhe sipas Vendimit për miratimin HZK për periudhën 2022-2030 Nr.001-011-48192 të dt 31.03.2022, dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 27, 44, 46, 47, 48 të L.P.P.A nr.05/L-031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

A K T V E N D I M

I L E J O H E T - Lon Gjurgjaj nga Prizreni me banim në rrugën “ Anton Qeta” nr 78 , me të cilën pala ka kërkuar leje për: gropimin e rrugës dhe kuçje në rrjetin e kanalizimit të shtëpis individuale për banim.

I. Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.

II. Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures të kryhen sipas pëlqimeve të dhëna, kurse vend punishtja natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjaherë nga rruga ku janë kryer punimet.

III. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

IV. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.

V. Pas përfundimit të ndërtimit investitori duhet të parashtojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12 (dymbdhjetë) muajsh, duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës.

Investitori duhet të përmbahet kushtimisht dokumenteve:

- Pëlqim nga “Hidroregjioni Jugor” nr.1610 dt.04.03.2026
- Pëlqim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike nr.ref.04-343/01-13691 dt.26.02.2026
- Informatë për infrastrukturën e KEDS-it nr.536 dt.19.08.2026,
- Pëlqim parimor nga Vala me nr.175/2026 të dt.11.08.2026 .
- Vendimit të MKRS me nr. 74-2 dt. 26.03.2026

P.S. Investitori është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit,kanalizimit, PTK, KEDS-it,si dhe avari tjera ti evitoj dhe ti kthej në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

A r s y e t i m

Lon Gjugjaj nga Prizreni me banim në rrugën “Anton Qeta” nr.78,është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes për : gropimin e rrugës dhe kuçje në rrjetin e kanalizimit .

Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:


Në procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për : **gropimin e rrugës dhe kuçje në rrjetin e kanalizimit** në rrugën e “ Anton Qeta” nr.78.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPH së-Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxh.dip.ark.

DREJTORI:



Florent Ukaj , ecc dip.

